



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI KOMBËTAR I KONTABILITETIT

Adresa: Bul. "Dëshmorët e 4 Shkurtit" Nr. 6 / Pranë ILDKP, Tiranë
Tel: 042 220 499 *E_mail:* info@kkk.gov.al *WebSite:* www.kkk.gov.al

PROCESI ZYRTAR I RISHIKIMIT TË PËRKTHIMIT
NË GJUHËN SHQIPE TË SNK/SNRF-ve

Politikat e rishikimit

- 1.1 Procesi i përkthimit të SNK/SNRF është zhvilluar për të realizuar një përkthim me cilësi të lartë e të saktë që reflekton kuptimin origjinal të gjuhës angleze. Procesi i përkthimit ka dy hapa:
 - a) Përkthimi (i cili bëhet nga përkthyes profesionistë); dhe
 - b) Rishikimi (i cili bëhet nga një grup ekspertësh në fushën e raportimit financiar)

- 1.2 Qëllimi i përkthimit nuk është të interpretojë apo shpjegojë standardet ndërkombëtare të kontabilitetit dhe raportimit financiar, por të sigurojë një tekst në gjuhën shqipe pa ndryshime nga origjinali në gjuhën angleze. Sa më sipër, nënkupton që përkthyesit dhe anëtarët e Komitetit të Rishikimit nuk mund të shtojnë, pakësojnë ose të ndryshojnë thelbin dhe përmbajtjen e SNK/SNRF-ve të miratuara nga BSNK (IASB). Janë të lejuara vetëm adaptimet gramatikore dhe të sintaksës, gjithnjë kur ato janë në funksion të përmirësimit të lexueshmërisë së tekstit të përkthyer.

Komiteti i Rishikimit

- 1.3 Për Komitetin e Rishikimit, caktohet një Kordinator i cili ka përveç menaxhimit të procesit të përkthimit dhe rishikimit, ka edhe përgjegjësinë finale për përmbajtjen e përkthimit. Vota e tij është me prim në rastet kur nuk arrihet një konsensus mes anëtarëve të Komitetit.

- 1.4 Përzgjedhja e anëtarëve¹ të Komitetit të Rishikimit bëhet paraprakisht nga Këshilli Kombëtar i Kontabilitetit ndërsa miratimi përfundimtar bëhet nga Grupi i Përkthimit, Adoptimit dhe të Drejtës së Autorit pranë Fondacionit të SNRF (IFRS Foundation). Anëtarët angazhohen në këtë Komitet Rishikimi mbi baza vullnetare.
- 1.5 Përzgjedhja që bën Këshilli Kombëtar i Kontabilitetit, synon krijimin e një grupi ekspertësh që përfaqësojnë kombinimin më të mirë të mundshëm të ekspertizës teknike, diversitetit të bizneseve ndërkombëtare dhe eksperiencës në treg, me qëllim që të sigurohet një përkthim me cilësi të lartë i SNK / SNRF-ve.
- 1.6 Kriteret për përzgjedhjen e anëtarëve të Komitetit të Rishikimit nga Këshilli Kombëtar i Kontabilitetit janë:
- a) **Gjuha shqipe gjuhë amëtare.** Është shumë e rëndësishme që anëtari i Komitetit të Rishikimit të ketë gjuhën shqipe si gjuhë amëtare.
 - b) **Nohje dhe kuptueshmëri shumë të mirë të gjuhës angleze, inkurajohet të folurit rrjedhshëm i saj.** Rishikimi i tekstit të përkthyer në gjuhën shqipe bëhet duke e ballafaquar atë me tekstin original në gjuhën angleze të miratuar dhe publikuar nga BSNK (IASB).
 - c) **Eksperiencë pune që dëshmon aftësinë teknike dhe njohuritë mbi kontabilitetin dhe raportimin financiar.** Pavarësisht nëse anëtarët e Komitetit të Rishikimit vijnë si profesionistë kontabël, hartues pasqyrash financiare apo akademikë, ata duhet të dëshmojnë një nivel të lartë të njohurive dhe aftësisë teknike mbi kontabilitetin dhe raportimin financiar. Njohuri dhe aftësi të tilla rrisin besueshmërinë, efektivitetin dhe eficientësinë e procesit të përkthimit.
 - d) **Angazhim në një mision me interes publik.** Anëtarët e Komitetit të Rishikimit duhet të angazhohen në këtë mision me interes publik me qëllim përmbushjen e objektivave të KKK për sigurimin e një teksti të përkthyer në gjuhën shqipe me cilësi të lartë dhe pa ndryshime nga teksti origjinal i SNK / SNRF-ve. Rishikuesit firmosin me IFRS² Foundation një kontratë për të drejtën e autorit të materialit të përkthyer ndërsa përfituesi (KKK) ju njeh atyre me të drejtë vlerën për kontributin e përkthimit duke publikuar emrat e tyre në ëbsite-n zyrtar të Institucionit. Gjithashtu, kontributi i anëtarëve të Komitetit të Rishikimit do të vlerësohet edhe përmes publikimit të emrave të anëtarëve të Komitetit të Rishikimit në ëbsite-n zyrtar të IFRS Foundation.
- 1.7 Kur gjuha e përkthimit (gjuha shqipe) është gjuha zyrtare e më shumë se një juridiksioni, KKK duhet të përzgjedhë si anëtarë të Komitetit të Rishikimit nga një përfaqësues të çdo juridiksioni tjetër që përdor SNK/SNRF, me qëllim që të sigurohet pranueshmëria ndërkombëtare e përkthimit.

¹ Individët e interesuar, nëse gjykojnë se plotësojnë kriteret e miratuara, aplikojnë me CV e tyre pranë KKK për anëtar të Komitetit të Rishikimit.

² Për detaje të tjera, lutemi referojuni IFRS Foundation's Translation, Adoption & Copyright Policy at: <http://go.ifrs.org/TAC-Policy>